



Pranuar / Dorezuar Prenjano / Predato Received / Delivered	28 . 12 2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM SHCK	3322 / 2020		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.376/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 2775/2020 të datës 26.11.2020 të parashtruar nga ankuesi N.N me adresë banimi rr "Asllan Dinaj" fshati Skivjan-Gjakovë, kundër organit të punësimit- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.12.2020, mori këtë .

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.376/2020 e datës 26.11.2020 e parashtruar na ankuesi N.N.

A r s y e t i m

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me datën 28.01.2020 ka shpallur konkursin me nr.341/2020 për pozitën "Drejtor i Departamentit të Inspektoratit" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi N.N i cili ju ka nënshtruar testit me shkrim por jo edhe intervistës me gojë. Me datën 03.04.2020 ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me pretendimin ankimor mosrespektimi i dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve nuk e ka shqyrtuar fare ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor i Departamentit të Inspektoriatit për Trashëgimi Kulturorë, më datë 26.11.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2775/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.. Me datë 09.12.2020 organi i punësimit ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2775/2020 të datës 26.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit i datës 28.01.2020; Ankesë e datës 03.04.2020 me numër protokoll 1135/2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit; E-mail i datës 18.02.2020; Njoftim i datës 02.03.2020 me numër protokoll 909/2020; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 09.07.2020 me numër protokoll 2347/2020; kërkesë për fillimin e rekrutimit i datës 20.01.2020; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Drejtor i Inspektoriatit të Trashëgimisë Kulturore; E-mail i datës 03.04.2020; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Lista e ngushtë e datës 11.02.2020; Lista e ngushtë për test me shkrim e datës 21.02.2020; e-mail i datës 20.02.2020; testi me shkrim i datës 21.02.2020; Lista e ngushtë për intervistë me gojë e datës 02.03.2020; Formularët e Vlerësimit individual; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 02.03.2020; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 02.03.2020; dhe përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 09.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit N.N, është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve me datë 28.01.2020 ka shpallur konkursin për pozitën Drejtor i Inspektoriatit për Trashëgimi Kulturore në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi N.N i cili ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe ka marrë 78 pikë, por nuk ka marrë pjesë në intervistën me gojë. I pakënaqur me procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor i Inspektoriatit për Trashëgimi Kulturore, me datë 03.04.2020 ka parashtruar ankesë me nr.1135/2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, mirëpo nuk ka marrë përgjigje, rrjedhimisht duke e pas parasysh që institucioni që shqyrton kërkesën aktin administrativ e nxjerr brenda 30 ditësh sipas nenit 135 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës”***, atëherë ankuesit afati për ankim kundër heshtjes administrative ka filluar ti rrjedh kur afati për vendosje ka kaluar siç përcaktohet me nenin e lartcekur, kështu ankimi administrativ kundër heshtjes administrative nuk ka filluar sipas nenit 127 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”***.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk e ka shqyrtuar ankesën e datës 03.04.2020, dhe pasi që nuk ka marrë përgjigje ankuesi më datë 26.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e jashtafatshme dhe në kundërshtim me ligjin e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Lënda me numër A.nr.376/2020, 28.12.2020

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit N.N;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së